

RELACION TEKNIK

Shkurt 2023

Per objektin :“Sistemim i perroit te Gjepales dhe i perroit qe lidh Pallatin e “Jashareve” me lumin “Erzen”.

Sistemimi dhe disiplinimi i ketyre dy perrenjve del i domosdoshem per arsye te gerryerjes qe i shkaktojne tokes (terrenit) nga ujrat ,ne te dy anet e brigjeve te tyre ,rrezikut per jeten e njeresve,si dhe eliminimit te ndotjes mjedisore,duke e zgjeruar vazhdimisht shtratin e tyre ne te dy brigjet deri ne shkarkimin e tyre ne lumen “Erzen”.

Lidhur me kete arsye ,del e domosdoshme qe ujrat e ketyre perrenjve te disiplinohen e te shkarkohen ne lume nepermjet tubacioneve rretthore,te mbyllur prej betoni te armuar,dhe perkatesisht perroi i Gjepales me dy tubacione paralele me tuba b/a me diameter 200 cm dhe perroi qe lidh pallatin e “Jashareve” me lumen “Erzen” me nje tubacion prej b/a me diameter 100 cm.

- 1.Fillimisht do te behet germimi dhe trasimi i perrenjve,duke krijuar shtratin e vendosjes se tubacioneve dhe nivelimi i tij me nje shtrese zhavorr lumi me $t=15$ cm si dhe nivelimin me nje shtrese rrafshuese betony te M-250,me trashesi 10 cm.
- 2.Pjerrësia e krijuar pas shtresave te zhavorrit dhe betonit ,para vendosjes se tubacioneve,nuk duhet te jete me e vogel se 0.5 %.
- 3.Tubacionet qe do te perdoren per sistemimin e ketyre perrenjve do te jene perkatesisht tuba betoni te armuar me diameter te brendshem 200 cm (2 rreshta) per perroin e Gjepales dhe tuba prej b/a me diameter te brendshem 100 cm per perroin qe lidh pallatin e “Jashareve” me lumin “Erzen”.
- 4.Pas montimit me vinc i tubacionit,bashkimet midis tubave do te behet me fuga me llac cemento 1:2.
- 5.Gjithashtu ne hyrje te tubacioneve do te ndertohet portal i hyrjes prej betoni te armuar M-300 sipas projektit si dhe vepra e shkarkimit unaze b/a M-300 ne dalje te perrenjve ku bashkohen me lumin “Erzen”,per te perballuar presionin e daljes (shkarkimit) te ujrave.
- 6.Se fundi,do te behet mbushja e tubacioneve dhe e perrenjve me mbeturina ndertimi dhe dhe si dhe ngjeshja me fadrome.

Relatues

Ing.Gjergj Cifligu